



# Lindja Anonime dhe Kutia Adoptimit në Steiermark

**Nëse jeni shtatëzëne dhe nuk keni  
mundësi të jetoni me fëmijen tuaj, ...**

Agjencia Lindja Anonime, Kutia  
Adoptimit (Anonyme Geburt Baby-  
klappe) ju ofron, Informacion, këshillim,  
shoqërim me këtë numër telefoni

**0800 83 83 83**

Informacione te rendeshishme:

**Lindja anonime është gratis, pa të dhënat e emrit dhe mbiemrit tuaj**

Është e mundur në këto spitale të Republikës së Shtajmermarkut:

Deutschlandsberg, Feldbach, Graz, Hartberg, Hochsteiermark (Leoben),  
Murtal (Judenburg), Rottenmann dhe Schladming.

**Për transportin anonim dhe ndihmën e parë mund të kontaktoni dhe numrin 144.**

Kutia e Adoptimit është një **vend i sigurve** për ta lënë foshnjën tuaj.

Në rastin kur nuk mundeni dhe nuk doni të pranoni lindjen anonime kutia e adoptimit gjëndet në **murrin e jashtëm të Spitalit të lindjes, Auenbruggerplatz 18, në Graz.**

**Si fillim përgjegjesinë për foshnjën e merr zyra sociale për fëmijet dhe sa me shpejtë të jetë e mundur kjo zyrë e dorezon femijën nën kujdes të prinderve të ardhshëm adoptues.**

## **Të gjithë fëmijet bëjnë pyetje kur rriten për prejardhjen e tyre:**

Ju lutemi lëni disa fjalë të shkruara, me dëshirat e juaja në lidhje me fëmijën tuaj. Ju mund të lini për kujtim dhe një dhuratë të vogël, që mbase një ditë do të jetë shumë kuptimplotë dhe e rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të fëmijës tuaj.

## **Sa kohe keni për të ndryshuar vendimin?**

Në rast se të gjitha kushtet janë plotësuar, ju keni mundësinë për të marrë fëmijën mbrapsht deri në momentin para se të filloi procesi i adoptimit. Për këtë vendim duhet marrë dhe dakordesia e gjyqit për të drejtën e adoptimit. Për informacion shikoni si me poshte: <https://www.gesundheit.gv.at/leben/eltern/geburt/geburtsvorbereitung/anonyme-geburt-babyklappe.html>

## **Mundesite tjera:**

- Dorëzimi i fëmijës për adoptim të hapur, adoptim gjysmë i hapur dhe adoptimin anonim të fëmijës,
- Vendosja e fëmijës nën kujdesin e huaj
- Vendosja e juaj dhe e fëmijës në shtëpinë për strehimin e nënës dhe fëmijës.
- Të jetoni me fëmijën në shtëpi tuaj me mbështetjen dhe ndihmen e zyrës sociale për fëmijët.



**Informacione më të gjëra ne lidhje me lindjen anonime dhe Kutinë e Adoptimit si dhe të gjitha mundësitë tjera mund ti merrni në adresen:**

Grabenstraße 39, 8010 Graz  
Tel 0676 88015 - 218 ose -7167

**Falas Hotline: 0800 83 83 83**

[kontaktstelle@caritas-steiermark.at](mailto:kontaktstelle@caritas-steiermark.at)



**GESUNDHEITSFONDS**  
STEIERMARK



**Caritas**